



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 3177
Nr. Llog. 2	Data 04/02
Nr. Pa.	2026
Komuna e Kamenicës Opstina Kamenica Kamenica Municipality	



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.14, datë; 04.02.2026

Kryetari i Komunës së Kamenicës, z. Kadri Rahimaj, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, si dhe me qëllim të themelimit dhe funksionalizimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Kamenicës, shpall këtë:

FTESË PUBLIKE

Për propozimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Ftohen subjektet dhe përfaqësuesit e komuniteteve që, në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012, kanë të drejtë të propozojnë anëtarë për përbërjen e KKSBB-së, që të paraqesin propozimet e tyre brenda afatit të përcaktuar me këtë ftesë.

Qëllimi dhe roli i KKSBB-së

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) shërben si mekanizëm këshillëdhënës, koordinues dhe bashkëpunues, me qëllim të parandalimit të dukurive që cenojnë sigurinë publike dhe përmirësimit të sigurisë në bashkësi.

Në kuadër të funksionimit të tij, KKSBB-ja:

- identifikon dhe analizon dukuritë negative dhe rreziqet që kërcënojnë sigurinë publike në territorin e komunës;
- rekomandon masa dhe plane veprimi për adresimin e çështjeve të sigurisë tek autoritetet komunale dhe institucionale përkatëse;
- koordinon dhe forcon bashkëpunimin ndërmjet komunës, Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera relevante, pa ndërhyrë në kompetencat e tyre ligjore;
- kontribuon në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve për rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve;
- nxit dhe mbështet partneritete ndërinstitucionale dhe ndërkomunale, për çështje të sigurisë që i tejkalojnë kufijtë e një komune;
- shërben si urë lidhëse ndërmjet qytetarëve, komuniteteve dhe institucioneve, duke ndërtuar besim dhe dialog të vazhdueshëm;
- siguron një forum për diskutim dhe shkëmbim informacioni lidhur me sigurinë në bashkësi, në përputhje me ligjin dhe pa ndërhyrë në proceset hetimore.

Subjektet që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë

Në përputhje me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012, të drejtë propozimi për anëtarë të KKSB-së kanë:

- nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetar e në Komunën e Kamenicës;
- nga një përfaqësues i secilit komunitet etnik në Komunën e Kamenicës;
- një përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në Komunën e Kamenicës;
- një përfaqësues nga mediat lokale në Komunën e Kamenicës;
- një përfaqësues nga komuniteti i biznesit në Komunën e Kamenicës;
- një përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Kamenicës.

Anëtarët e tjerë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi caktohen sipas detyrës zyrtare, në përputhje me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL, dhe nuk janë subjekt i kësaj ftese publike.

Në rast se ndonjë komunitet etnik nuk propozon përfaqësuesin e vet brenda afatit të përcaktuar me këtë ftesë publike, Kryetari i Komunës ose Nënkryetari shtesë i Komunës, në konsultim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, propozon përfaqësuesin e komunitetit përkatës për anëtar të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL.

Afati dhe mënyra e paraqitjes së propozimeve

Propozimet për anëtarë të KKSB-së duhet të dorëzohen brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke filluar nga dita e publikimit të kësaj ftese publike.

Propozimet duhet të përmbajë:

- emrin dhe mbiemrin e kandidatit/es,
- subjektin propozues,
- të dhënat e kontaktit,
- dëshmi të përfaqësimit legjitim.

Propozimet dorëzohen:

- në Qendrën për Shërbim me Qytetarë,
- objekti i Komunës së Kamenicës,
- në zarf të mbyllur, me shënimin: "Propozim për anëtar të KKSB-së".

Vërejtje


Propozimet e dorëzuara pas përfundimit të afatit të përcaktuar me këtë ftesë publike nuk do të merren në shqyrtim.



Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kancelarija Predsednika

Š 02, Br. 14, datum; 04.02.2026

Predsednik Opštine Kamenica, g. Kadri Rahimaj, na osnovu Administrativnog Uputstva o Opštinskim Savetima za Bezbednost u Zajednici br. 27/2012 MUP-03/2012 MALS-a, kao i u cilju osnivanja i funkcionisanja Opštinskog Saveta za bezbednost u Zajednici (OSBZ-e) u Opštini Kamenica, objavljuje ovaj:

JAVNI POZIV

Za predlog članova Opštinskog Saveta za Bezbednost u Zajednici (OSBZ-e)

Pozivaju se subjekti i predstavnici zajednica, da u smislu odredaba Administrativnog Uputstva Br. 27/2012, imaju pravo da predlažu članove za sastav OSBZ-e, i podnose njihove predloge u okviru roka utvrđeno ovim pozivom.

Svrha i uloga OSBZ-e

Opštinski Savet za bezbednost u Zajednici (OSBZ) služi kao savetodavni, koordinacioni i kolaborativni mehanizam, ciljem sprečavanja pojava koje ugrožavaju javnu bezbednost i poboljšava bezbednost u zajednici.

U sklopu njegovog funkcionisanja, OSBZ-e:

- identifikuje i analizira negativne pojave i opasnosti koje ugrožavaju javnu bezbednostu na teritoriji opštine;
- preporučuje mere i akcione planove za adresovanje po pitanju bezbednosti kod opštinskih organa i dotičnih institucija;
- koordinira i jača saradnju između opštine, Kosovske Policije i drugih relevantnih institucija, bez intervencije u njihove zakonske nadležnosti;
- doprinosi planiranju i razvoju projekata za povećanje bezbednosti i blagostanja građana;
- podstiče i podržava međuinstitucionalno i međuopštinsko partnerstvo po pitanju bezbednosti koji prelaze granice opštine;
- služi kao most između građana, zajednica i institucija, izgradnjom poverenja i kontinuiranog dijaloga;
- obezbeđuje forum za raspravu i razmenu informaciju u vezi bezbednosti u zajednici, u okviru zakona i bez intervencije u istražnim procesima.

Subjekti koji imaju pravo da predlažu članove

U skladu sa članom 4 Administrativnog Uputstva Br. 27/2012, pravo predlaganja za člana OSBZ-e imaju:

- po jednog legitimnog predstavnika iz svake verske zajednice u Opštini Kamenica;
- po jednog predstavnika iz svake etničke zajednice u Opštini Kamenica;
- jednog predstavnika organizacije civilnog društva koje deluju u Opštini Kamenica;
- jednog predstavnika lokalnih medija u Opštini Kamenica;
- jednog predstavnika iz poslovne zajednice u Opštini Kamenica;
- jednog predstavnika iz zajednice lica sa invaliditetom u Opštini Kamenica.

Ostali članovi Opštinskog Saveta za Bezbednost u Zajednici imenjuju se po službenoj dužnosti u skladu sa članom 4 Administrativnog Uputstva Br. 27/2012 MUP-03/2012 MALS, i koji nisu subjekat ovog javnog poziva.

U slučaju da neka etnička zajednica ne predlaže svog predstavnika u okviru utvrđenog roka ovim javnim pozivom, Predsednik Opštine ili dodatni Potpredsednik Opštine u konsultaciji sa Opštinskom Kancelarijom za Zajednice, predlaže predstavnika dotične zajednice za člana Opštinskog Saveta za Bezbednost u Zajednici (OSBZ) u skladu sa Administrativnim Uputstvom br. 27/2012 MUP-03/2012 MALS.

Rok i način prijave predloga

Predloge za člana OSBZ-e treba dostaviti u roku od 15 (petnaest) dana, počev od dana objavljivanja javnog poziva.

Predlog mora sadržati:


- ime i prezime kandidata/tkinje,
- subjekta predlagača,
- kontakt detalje,
- dokaz o legitimnom zastupanju.

Predlozi se dostavljaju:

- u Centar za Usluge Građanima,
- objekat Opštine Kamenica,
- u zatvorenoj koverti sa beleškom: "Predlog za člana OSBZ-e".

Primedba

Predlozi dostavljeni nakon završetka utvrđenog roka, ovim javnim pozivom neće se uzeti u obzir na razmatranje.


Predsednik Opštine

Kadri Rahimaj